



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 266, Datë 14.10.2022

MBI

**MOS FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY TRADE” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr.96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1799/3 prot., datë 12.10.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes “Mbi mos fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ALB ENERGY TRADE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “ALB ENERGY TRADE” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1770 prot., datë 06.10.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar së fundi me vendimin nr. 220, datë 01.09.2022 dhe hyrë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare nr. 125, datë 20.09.2022., aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhej të depozitonte në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisjen me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).

- Shoqëria e ka kryer aplikimin në datën 06.10.2022, pas hyjes së fuqi të ndryshimeve të rregullores së licencimit (datë 20.09.2022), por jo sipas këtyre ndryshimeve, por sipas kërkesave dhe formateve të saj të mëparshme. Gjithashtu dokumentacionit rezulton se ka pasaktësi dhe vërehet se shoqëria nuk ka realizuar pagesën e aplikimit për t'u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Duke qenë se nuk është kryer pagesa për aplikimin për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe dokumentacioni i depozituar nuk mund të merret në shqyrtim nga ERE.
- Në mbështetje të parashikimit të nenit 10 pika 7 të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”* e ndryshuar, aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të ERE-s për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit dhe dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri, i cili duhet të përmbajë bashkëlidhur edhe pagesën e aplikimit për licencim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ALB ENERGY TRADE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të bordit të ERE-s dhe dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**